



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:227762

Datë: 11.07.2024

Numri i dokumentit: 05928778

**AC-I-23-0128**

**Në çështjen juridike të:**

**Paditësja/ankuesja**

**N.T.P, " Zh I"-** me seli në fshatin LI të Komunës së Podujevës të cilën e përfaqëson, av. A S nga Prishtina.

**Kundër:**

**E paditura**

**N.SH "I.M.F Kosova"** (në likuidim), Prishtinë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-15-0190, të datës 03 shkurt 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 korrik 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë i DHPGJSK-së C-IV.-15-0190, i datës 03 shkurt 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedure ankimore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 03 mars 2015, paditësja NTP'' Zh I'', parashtroj ankesë në DHPGJSK, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN008-0036 të datës 17 tetor 2014, më të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensim të borgjit për shërbimet e kryera në shumë prej 29,367.00 euro, ndërsa ishte aprovuar shuma prej 58,407.00 euro nga NSH " I.M.F Kosova", (në likuidim). Pretendimet e paditëses për rishikimin e vendimit qëndrojnë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale, me të cilën e kundërshton vendimin vetëm në pjesë refuzuese në shumë prej 29.367.00 euro, kurse në pjesën e pranuar vendimi mbetet i pa ndryshuar. Ajo konsideron se Vendimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm për arsye se kërkesa e saj bazohet në aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë C.nr.120/2007, dhe si i tillë është çështje e gjykuar për borxhin kryesor me kamatën dhe mbi këtë bazë në këtë çështje nuk mund të aplikohet dispozita e nenit 37 e të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Tutje pretendon se AL-ja ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale duke shkelur Ligjin në dëm të paditësit në pjesën refuzuese të vendimit andaj kërkon që vendimi i kundërshtuar në pjesën refuzuese nuk mund të qëndrojë duhet të ndryshohet duke e aprovuar ankesën e saj. Kërkesës për rishikimin e vendimit si prova i ka bashkangjitur: Vendimin, PRN008-0036 të datës 17 tetor 2014 të AL-së, aktgjykimin C.nr.120/2007 i datës 18 tetor 2007 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut dhe aktgjykimin SCA-08-0023 i datës 22 prill 2008 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Më 27 shtator 2017 e paditura, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj në këtë gjykatë ka parashtuar mbrojtjen e saj në ankesën e paraqitur nga pala paditëse dhe ka theksuar se me rastin e vendosjes, Autoriteti i Likuidimit (AL), mori vendimin duke miratuar kërkesën në bazë të aktgjykimit, VI.C.nr.120/2007 datë 18 tetor 2007 në shumën 51.677.00 euro +1.580.00 euro si shpenzime gjyqësore +5.160.00 euro si kamatë mbi vlerën e pranuar nga gjykata ndërsa e ka refuzuar në shumën 29.367.00 euro në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP i cili parashikon shumën e kamatës të miratuar nga AL-ja në vlerën prej 10% e cila dispozitë zbatohet përkundrajt çdo dispozite tjetër në legjislacion që është në kundërshtim me të në përputhje me nenin 31 Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Ka

kërkuar nga gjykata që ta refuzojë ankesën si të pa pranueshme/ të pa bazuar dhe ta vërtetojë vendimin e AL-së.

Më 03 shkurt 2023, Shkalla e parë e DHPGJSK-së ,me Aktgjykimin C-IV-15-0190, e ka refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses , NTP" Zh I" dhe ka vërtetuar vendimin e AL , PRN008-0036 të datës 17 tetor 2014, si i drejtë dhe të bazuar në ligj, dhe ka vendosur qe secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Shkalla e I-rë ka arsyetuar nuk është kontestuese se në mes të palëve ndërgjygjse se ka qëndruar raporti juridik sipas aktgjykimit të formës se prerë VI.C.nr..120/2007 të datës 18 tetor 2007, po në mes palëve ndërgjygjse mbetet kontestuese lartësia e kërkesës të cilën ka pretenduar paditësja mbi bazën e ekspertizës financiare datës 31 janarit 2006 në shumë prej 87.774.00 euro dhe se AL-ja me Vendimin e saj PRN008-0036 të datës 17 tetor 2014 e ka miratuar kërkesën në shumë të përgjithshme prej 58.407.00 euro, ndërsa e ka refuzuar kërkesën e paditëses në shumë prej 29.367.00 euro.

Shkalla e I-rë në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se ka marrë në zbatim aktgjykimin VI C.nr.120/2007 të datës 18 tetor 2007 të Gjykatës ekonomike të Qarkut në Prishtinë si dhe dispozitën nga neni 37 par.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP i cili në mënyrë shperhimore përcakton se: " të gjitha kërkesat e bëra ndaj ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamate të mos tejkalojë 10% ( dhjetë për qind) të shumës themelore" lidhur me nenin 31 par.1 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në dhe i cili parasheh se: " ky ligj mbisundon çdo dispozitë tjetër të se drejtës në Kosovë që është në kundërshtim me të ". Andaj si rezultat i këtij kishte konstatuar se AL-ja, drejtë ka vepruar me rastin e miratimit të kërkesës së paditëses në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, VI.C.nr.120/2007 të datës 18 tetor 2007 dhe i vërtetuar me aktgjykimin, SCA-08-0023 të datës 22 prill 2008 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). Pra AL-ja drejtë kishte vepruar meqë nuk ka pasur bazë juridike për aprovimin e pjesës refuzuese të kërkesës së paditëses në shumën prej 29,367.00 euro, dhe se Ligji nuk është zbatuar në dem të paditëses.

Më 02 shkurt 2023, paditësja/ankuesja ka parashtruar ankesë nëpërmjet përfaqësueses kundër aktgjykimit të Shkalla e I-rë C-IV-15-0190, për shkak të vërtetimit të gabuara dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar ashtu që të anulohet aktgjykimi i atakuar, lënda të kthehet në rishqyrtim ose ta ndryshoj atë duke aprovuara kërkesën e paditëses si të bazuar. Kjo për faktin se në Aktgjykimin me nr. IV.C.nr.120/2007 të datës 18 tetor 2007 të nxjerrë nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë i është aprovuar kërkesëpadia e paditësit NTP " Zh I" dhe me të cilin është obliguar IMF " Kosova" nga Fushë Kosova" që t'ia paguajë borxhin në shumë prej 51,677.60 dhe me 3.5% kamatë në vit llogaritur nga dita e parashtrimit të kërkesëpadiës e deri në pagesën definitive të borxhit duke arritur kështu shuma e përgjithshme për pagesë 87,774.00 euro, AL pa asnjë të drejtë po përkundrazi duke shkelur ligjin nuk ka zbatuar në tersi Aktgjykimin e lartcekur si në dispozitiv. Në ankesën e parashtruar paditësja nëpërmjet përfaqësuesit ka theksuar se Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së ka lëshuar se vërtetuari se ndaj paditësit/ankuesit është bërë shkelja e të drejtës materiale marrë parasysh faktin se vendimi i gjykatës duhet të zbatohet në përpikmëri dhe në përputhje të plotë me përmbajtjen e tij në dispozitiv ku në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit është konsideruar në tersi si e bazuar dhe askush nuk guxon ta marrë të zbatuar vetëm pjesërisht se vetëm gjykata gëzon të drejtën absolute të lëshojë aktgjykime të pjeshme dhe në qoftë se do të ishin plotësuar kushtet ligjore atëherë do të kishte vepruar edhe në këtë rast me aktgjykim të pjeshem duke refuzuar kamatën, por ja që Gjykata ka konsideruar se e gjithë kërkesëpadia e paditësit përfshirë edhe kamatë a janë plotësisht të bazuara. Lidhur me këtë dhe mbi të gjitha theksojmë se është fakt notor dhe juridik se Aktgjykimet e plotfuqishme të Gjykatës kanë fuqinë e Ligjit për palët dhe duke qenë kështu nuk mund të aplikohet paralelisht asnjë Ligj tjetër me një Aktgjykim të formës së prerë duke i humbur fuqinë e vete aktgjykimit, thënë më mirë duke e shkelur Aktgjykimin me përpjekjet për të kombinuar diapozitivin me një ligj tjetër. Po ashtu paditësja duke ju referuar nenit 37.par3, të Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë kosovare të Privatizimit i cili thotë se :” të gjitha kërkesat e bëra ndaj ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10%( dhjetë për qind) të shumës themelore”, ka theksuar se të një çështje e gjykuar në formë të prerë nuk mund të aplikohet dispozita e nenit 37/3 të Shtojcës së Ligjit nr.04/LL-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Me 05 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj ankesës. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se argumentet e veta qartësisht i ka sqaruar në mbrojtjen në ankesë, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me datë 19 qershor 2008, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH "I.M.F Kosova" (në likuidim), një kërkesë për kompensim të borxhit në shumë prej 87,774.00 euro, për shërbimet e kryera përkatësisht dërgimit të mallit për NSH "I.M.F" Kosova, por që Autoritetit të Likuidimit me Vendimin PRN008-0036 të datës 17 tetor 2014, e kishte aprovuar shumën prej 58,407.00 euro, duke përfshirë kamatën prej 10 % si dhe shpenzimet e procedurës, ndërsa kishte refuzuar kërkesën e paditëses që ka të bëjë me shumën prej 29,367.00 euro si te pajustificuar.

Kundër vendimit të AL PRN008-0036, paditësja kishte paraqitur ankesë në Shkallë të I-rë të DHPGJS vetëm sa i përket shumës së refuzuar prej 29,367.00 euro duke pretenduar se i takon edhe kamata prej 3.5 % sipas aktgjykimit të formës së prerë. nr.VI C.nr.120/2007 të datës 18 tetor 2007 të Gjykatës ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

Shkalla e parë e DHPGJSK-së me Aktgjykimin C-IV-15-0190, të dt. 03 shkurt 2023, e ka refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses , NTP" Zh I" dhe ka vërtetuar vendimin e AL , PRN008-0036 të datës 17 tetor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Kolegji i Apelit pajtohet me arsyetimin dhe vlerësimin e dhen nga Shkalla e I-rë se nuk është kontestuese se në mes të palëve ndërgjyqjse se ka qëndruar raporti juridik sipas aktgjykimit të formës se prerë VI.C.nr.120/2007 të datës 18 tetor 2007. Në mes palëve ndërgjegjes ishte kontestuese lartësia e kërkesës prej 29,367.00 euro të cilën ka pretenduar paditësja mbi bazën e kamatës prej 3.5 % në vit prej ditës së parashtrimit të padisë, e të cilën e kishte kundërshtuar e paditura duke i njohur vetëm shumën e kalkuluar prej 10% te kamatës sipas nenit 37 par.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP.

Kolegji i vlerëson se Shkalla e I-rë DHPGJS ka aplikuar drejtë dispozitën e nenit 37 par.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP i cili në mënyrë shperhimore përcakton se: " të gjitha kërkesat e bëra ndaj ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% ( dhjetë për qind) të shumës themelore". Po ashtu edhe neni 31 par.1 i Ligjit 04/L-034 për AKP-në, parasheh se: " ky ligj mbisundon çdo dispozitë tjetër të se drejtës në Kosovë që është në kundërshtim me të ", andaj rezultati i dhen nga AL-ja, dhe Shkalla e parë vlerësohet të jetë i drejtë dhe i mbështetur në dispozita ligjore.

Kolegji i Apelit ka vlerësuar pretendimet e paditëses lidhur me atë se aktgjykimi i ankimuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuara dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ka gjetur se përfundimet e paditëses janë të pathemelta ngase Shkalla e I-rë ka vlerësuar provat e ofruara nga palët ndërgjyqëse dhe ka marr aktgjykim i cili sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit është i drejtë dhe i bazuar në Ligj. Kjo pasi që Shkalla e I-rë ka dhen arsye konkrete për faktet vendimtare duke dhen shpjegime dhe arsye adekuate dhe të bazuar në dispozita ligjore që i referohen kësaj çështje juridike.

Po ashtu pretendimet e paditëses se nuk është zbatuar drejtë e drejta materiale, nuk janë të themelta, kjo për shkak se siç arsyetuar me lartë Shkalla I-rë ka

aplikuara saktë dispozitat ligjore, andaj pretendimet e paditëses në këtë aspekt janë të pabazuar.

Kolegji i Apelit e vlerëson se Ligji për AKP me shtojcën e saj konsiderohet Ligj i veçantë ( *lex specialis*) që rregullon edhe procedurën e likuidimit të NSH si edhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e NSH ndaj kreditorëve dhe anasjelltas, në pajtim me dispozitat tjera ligjore në fuqi.

Kolegji i Apelit i mbështetë të gjeturat faktike dhe konstatimet e shkallës së I-rë të dhëna në Aktgjykimin e ankimuar, të cilat i konsideron si të drejta dhe të mbështetura në prova.

Andaj nga se u tha më lartë, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar, nuk ka mundësi të ndryshohet, andaj ankesa e paditëse refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksa gjyqësore**

Paditësja/ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro me datë 04 prill 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 11 korrik 2024

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_